



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS DEÇAN

Numri i lëndës: 2019:149332

Datë: 08.06.2021

Numri i dokumentit: 01860595

**C.nr.175/2019**

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË DEGA NE DEÇAN**, Departamenti i Përgjithshëm, si civile juridike më gjyqtarin Bekim Avdimetaj dhe me zyrtaren ligjore Edita Gashi në kontestin e paditesit Z. (Z.) K. Rruga .....nga .....kundër te paditurve B. (S.) A. nga .....Rruga .....nr.3 në ..... te cilin me autorizim e përfaqëson Avokati I. I. nga Peja, Xh. M. nga fshati .....Komuna e ..... dhe te paditurit E. K. nga fshati .....Komuna e ..... te cilin me autorizim e përfaqëson O. M. nga fshati .....Komuna e ..... për caktimin sinorëve ,vlera e kontestit 1000.00 euro ,gjykata pas përfundimit seancës të shqyrtimit kryesorë publike më datën 07.06.2021, në prezencën e paditësit te autorizuarit te paditurit te pare dhe te paditurit te pare dhe padituritë te dyte te paditurit të përpiluar më datën 08.06.2021, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

- I. APROVOHET** si e bazuar kërkesëpadia e paditësit Z. (Z.) K. Rruga .....nga .....
- II.** Parcela me numër 906-0 kufizohet ne pjesën veriore ne parcelën nr 907-3 e cila evidentohet ne emër te B. (S.) A. dhe me parcelen nr. 907-4 e cila evidentohet ne emër te Z. (J.) M.. ne lindje me parcelën nr 907-2 e cila evidentohet ne emër te Z. (Z.) K., ne pjesën jugore me parcelën nr . 909-0 e cila evidentohet ne emër te Rr. (T.) C. por sipas gjendjes faktike është rruge me emër .....ne pjesën perëndimore me parcelat me nr. 907-5 dhe 908-0 te cilat evidentohet ne emër te E. (R.) K..
- III.** Parcela me numër 907-3 kufizohet ne pjesën veriore me parcelën nr. 907-10 e cila evidentohet ne bashkëpronësi ideale me 2/8 Z. (M.) S. me 2/8 V. (M.) S., 1/8 M. (D.) S., 1/8 M. (R.) S., 1/8 B. (S.) A. por sipas gjendjes faktike është rruga me emrin Rr. B., ne pjesën lindore me parcelën 907-1 e cila evidentohet ne emer te Zh. (Zh.) Z. dhe parcelën nr. 907-2 e cila evidentohet ne emer te Z. (Z.) K.. Ne pjesën jugore me parcelën me nr. 909-0 e cila evidentohet emër Rr. (T.) C. por sipas gjendjes faktike është rruga me emër ....., ne pjesën perëndimore me parcelën nr 907-4 e cila evidentohet ne emer te Z. (J.) M.. Ne baze te evidencave kadastrale parcela 906-0 evidentohet ne emër te Z. (Z.) K. , parcela me nr 907-3 evidentohet ne emër te B. (S.) B..
- I.** Detyrohen te paditurit B. (S.) A. nga ..... ,E. K. nga fshati .....komuna e ..... ,Xh. M. nga fshati .....Komuna e ....., qe tija pranojnë paditësit Z. (Z.) K. Rruga

.....nga .....,vendosjen e vijave kufizuese ne mes parcelave te tyre dhe parcelave te paditësit sipas shënimeve kadastrale me afat prej 15 dite nga dita marrjes se këtij aktgjykimi e nen kërcenim te përmbarimit .

**V DETYROHET** te paditurit solidarisht paditësit për shpenzimet procedurës kontestimore te ja paguan shumen prej 270.00 euro te gjitha ne afat prej 15 ditëve nga dita e marrjes se aktgjykimit e nen kërcenim te përmbarimit.

### **A r s y t i m**

Paditësit Z. (Z.) K. Rruga .....nga .....ka paraqiture padi ne ketë gjykate kundër te paditurve B. (S.) A. nga ..... Rruga .....nr 3 te cilin me autorizim e perfaqeson Avokati I. I. nga Peja, Xh. M. nga fshati .....Komuna e .....dhe te paditurit E. K. nga fshati .....Komuna e .....te cilin me autorizim e përfaqëson O. M. nga fshati .....Komuna e .....për caktimin sinorëve.

Paditësi ne padi ka kërkuar për caktimin dhe rregullimin e mëxhave për parcelat nr 906-0 dhe parcelës 907-2 ne sipërfaqe te përgjithshëm prej 1320 m2 evidentuar sipas listës poseduese dhe kopjes se planit ne emer te paditësit zona kadastrale ne Deçan . Edhe përkundër marrëveshjes te paditurit por gjate matjeve te bëra nuk është pajtuar tani i padituri B. A. ku i cili vazhdimisht krijon probleme sa i përket vijave kufizuese me parcelën e paditësit dhe disa here janë hapur raste ne polici.

Andaj paditësi ka interes juridik ne vendosjen e vijave kufizuese per parcelat me nr . 906-0 Dhe 907-2 Sipas shënimeve kat astralë me parcelat kufizuese te paditurve duke i propozuar gjykates caktimin e nje eksperti gjeodezisë gjate daljes ne vende ngjarje per dalje dhe matje te pikave kufizuese te palujtshmerive me te paditurve.

### **Juridiksioni dhe kompetenca e gjykatës**

Neni 37 par.1 i Ligjit të Procedurës Kontestimore parashihet, nëse me ligj nuk është caktuar kompetenca ekskluzive territoriale e ndonjë gjykate tjetër, për procedimin e çështjes është kompetente gjykata e kompetencës së përgjithshme për palën e paditur

### **Pretendimet e palëve ndërgjyqëse dhe te autorizuarve te tyre**

Paditësi Z. K. gjate seancës përgatitorë dhe te shqyrtimit kryesore ka mbeture pran padis dhe krekës se saj duke i propozuar gjykatës për caktimin e një eksperti te gjeodezisë nga regjistri i gjykatës për daljen ne vend ngjarje për ta bere caktimin e sinorëve për parcelat me nr. 906-0 dhe 907-2 me te paditurit .

Paditësi i lartshënuar gjate seancës ka deklaruar se e ka pranuar ekspertizën e ekspertit pas daljes në vendin e ngjarjes dhe ndaj saj nuk kam vërejtje. Pajtohem me propozimin e të autorizuarit të parë te paditurit që për seancën e radhës të ftohet eksperti i gjeodezisë për te dhen sqarime për ekspertizën e kryer nga ana e ti .

Paditësi i lartshënuar në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar kërkojë nga gjykata që sa ma shpejt ta kryer këtë punë dhe të me gjej 9 ari e 53 të mi martë edhe me metër çdo pik që e kamë, nëse është nevoja të jua mat secilit të paditurve edhe me metër pranoi e të shohim kujt po i shtohet e kujt po i mungon , pikërisht aty te gjeneratori ku e kam berë unë prej ish pronarit të parë ka thësë se i kemi lejua këtu për mu marr në të kryt në laticë kam dëshmi se kanë qenë hunjtë e telit por pikërisht këta të paditurit i kanë hekë ato , kërkoj prej gjykate a kanë ndonjë dokument këta para 2010 –ës, i kërkoj të gjitha shpenzimet e procedurës 250 për ekspertizë , 20 euro koordinatat , 235 euro ekspertiza e parë, padia prej 20 euro , me sot janë 15 ditë që vijë në seancë d.m.th. e 15 seancë ka 25 dita bëjnë 375 euro.

**I autorizuari i paditurit të parë B. A. av. I. I. nga Peja** gjate seancës te shqyrtimit kryesore ka deklaruar parimisht ekspertizën e kundërshtoj dhe kam vërejtje në të njëjtën , propozoi që për seancën e ardhshme të ftohet eksperti apo grupi i ekspertëve të cilën e kanë hartuar të njëjtën që të na jepin sqarime plotësuese lidhur me zgjidhjen e kësaj çështje në mënyre të drejtë.

Kam edhe vërejtje tjera pikërisht në aspektin procedural të gjykatës lidhur me këtë çështje juridike ngase që nga fillimi e njëjta nga pakujdesia si duket nuk ka rrjedhur në procedurë të rregullt sepse kopja e padisë dhe aktvendimi me të cilën i padituri është udhëzuar në dhënie e përgjegjës në të edhe pse i padituri B. A. nuk ndodhet në Kosovë por jashtë shtetit, se ishte viti i pandemisë dhe rrallë her lejohej qarkullimi të njëjti këto shkresa i janë lënë në hyrje të shtëpisë dhe me vonës të madhe i ka pranuar. Megjithatë kemi ushtruar përgjigjeje në padi me dt. 28.09.2020, kemi konstatuar se përveç padisë dhe aktvendimit të gjykatës për dhënie në padi asnjë provë tjetër që përmendet në padi nuk i është bashkangjitur padisë . edhe pse kemi kërkuar në përgjigje asnjë deri tani nuk i kemi këto prova përveç ekspertizës . Nuk na kanë mundësuar marrja pjesë as në seancën fillestare që të propozojmë prova dhe po ashtu na u ka mohor një e drejtë themelore dhe e domosdoshme marrja pjesë në seancën e daljes në vend me ekspert që është domosdoshmëri e palëve në kontest që të prezantoj drejtpërsëdrejti ose të autorizuarit e tyre kur te caktohet stinoret në mes fqinjëve ( megjanikëve). Thirrjen për dalje në vend me dt. 12.02.2021 për në ora 13:30 ne e kemi pranuar me dt. 15.02.2021 që është e konstatuar edhe në flet kthesë pra tri ditë pas daljes në vend ngjarje , andaj për mos ta zgjatur gjykatës i propozojmë që ta detyroj paditësin në dorëzimin e provave të propozuara , ta thërras ekspertin apo grupin e eksperteve për seancën e radhës, për kur do të vij edhe i padituri dhe atë për hir të shpenzimeve me të njëjtin do ta shqyrtojmë ekspertizën , kërkojmë sqarime nga eksperti dhe plotësime në mënyrë që të mos dalim serish në teren për caktimin e pikave o sinorëve.

**I autorizuari i paditurit të parë Av. I. I. në faljen përfundimtare te tejj ka deklaruar** pas shqyrtimit të çështjes administrimit të provave të propozuara dhe thënieve këtu në seancë ne edhe me tutje pjesërisht e kontestojmë padinë e paditësit Z. K. si jo të bazuar . E cekem pjesërisht ngase nga ekspertiza e ekspertit të gjeodezisë shifet se sa i përket vijës përkufizuese në mes ngastrës apo parcelës 907-3 dhe asaj 906-0 të paditësit pas matjeve shifet se nga të dy palët nga ana e paditësit dhe të paditurit B. A. ka lëvizje- depërtime të vijës kufizuese në ngastrat e njeri tjetrit , kështu në bazë të llogarisë se berë nga raporti i ekspertit shifet se i padituri B. A. në pikën A dhe C ka depërtuar në palujtshmerinë e paditësit Z. K. me gjithsejtë 1.53 m2 , ndërsa i paditësi në pikën B të ekspertizës të vijës kufizuese dhe me vendin ku është i vendosur gjeneratori i tij ka depërtuar në ngastrën kadastrale 907-3 të paditurit B. me 1.63 m2 pra nga kjo shifet se përafërsisht depërtimet e tyre më shumë i ngjasojnë depërtimeve të pa qëllimshme duke mos e drejtuar mirë vijën kufizuese dhe këtu në këtë pjesë në pajtohemi që pas vendosjes se pikave nga

ana e ekspertit të gjeodezisë permisohet kjo gjendje e cila gjithashtu e përmison anën estetike të vijës kufitare duke e berë të njëjtën të drejtë.

Edhe me tutje mbetemi pran kundërshtimit lidhur me faktin se gjatësia e këtij kufiri në mes të këtyre dy ngastrave nga skica e më hershme kadastrale ndryshon dhe atë kjo vijë atëherë kishte gjatësinë 28.20 m ndërsa tani sipas ekspertizës respektivisht ckaçës se përmisuar të dorëzuar sot ka 27.35 m , nga kjo ne i propozojmë gjykatës që sa i përket drejtimit sipas sqarimit të parë gjykata ta aprovoi qëndrimin e skeprtit ndërsa çështja e gjatësisë se vijës kufitare mbetet kontestuese pra pjesërisht të aprovohet kërkesa padia dhe të harmonizohet me ekspertizën sa i përket depërtimeve në ngastrat e njëri tjetrit.

Ne i kërkojmë shpenzimet e procedurës dhe atë për padi prej 104 euro për 3 seanca nga 135 ero bëjnë 405 euro , ndërsa listën e paraqitur nga ana e paditësit e kontestojë të pa bazuar dhe pa mbështetje , gjykata e ka të njohur çështjen se po të kishte avokat do tu paguhen seancat

**I padituri Xh. M. gjate seancës te shqyrtimit kryesore ka deklaruar** e kam pranuar ekspertizën e ekspertit Gj. T. dhe kam vërejtje në të sikurse edhe i autorizuari i paditurit B. A. . Pajtohem me propozimin e të autorizuarit të paditurit të parë që për seancën e radhës të ftohet eksperti i gjeodezisë për të dhënë sqarime rreth ekspertizës se tij.

**I padituri Xh. M. në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se** nëse me del edhe 2 metra në territor të Zeçes unë ja fali krejt e nëse del 5-10 cm unë ja jepi paret.

Gjykata edhe pse e ka thirrur rregullisht te autorizuarin e te padituritë te dyte O. M. nga fshati .....K Deçan me ftesa ne mënyre te rregullt nuk ka ardhure dhe për arsyt e mos ardhjes nuk e ka njoftuar gjykatën me ndonjë parsh tres me shkrim andaj gjykata ka vepruar ne kuptim te neneit 161,423 par 4 te LPK

Gjykata gjate seancës te shqyrtimit kryesore e ka aprovuar propozimin e paditesit qe ka caktuar ekspertin e gjedozis Xh. T. nga Gjakova .

Nga certifikata e pronësisë me numër 15753 e lëshuar nga Zyra Kadastrale në Deçan me dt. 17.05.2019, vërtetohet se Z. (Z.) K. është pronarë i njësave kadastrale me numër P 70505021-00906-0, P 70505021-00907- 2,

Gjykata me datën 12.02.2021 ka dalur ne vendngjarje te shtëpia e paditësit Z. K. ne Rrugën .....ne Deçan me ekspertin e gjeodezisë Xh. T. qe prezent ka qene edhe i padituri B. A. per ta bere caktimin e sinorëve te palujtshmerive te paditësit te ngastrave me numër . 906-0 dhe 907-2 qe kufizohen me palujtshmerisë e te paditure vë .

Eksperti i gjeodezisë Xh. T. me datën 12.04.2021 ja ka dorëzuar me shkrim ekspertizën e tij te kryer gjykatës . Duke theksuar se ne pjesën qendrore te kufirit ndarës ne mes parcelave 906-0 dhe 907-3 nga pronari i parcelës 906-0 është vendosur stabilizuar gjeneratori montues me dimensione 2.48 m x=1.57 por nga gjatësia 1,57 m ka depërtuar ne parcelën me nr 907-3 ne gjatësi prej 0,22 cm te shënuar ne ekspertize te ekspertit të lartshënuar me grafik më shkronja A ,B,C.

Parcela më numër 906-0 kufizohet ne pjesën veriore ne parcelën nr 907-3 e cila evidentohet ne emër te B. (S.) A. dhe me parcelen nr. 907-4 e cila evidentohet ne emër te Z. (J.) M.. ne lindje

me parcelën nr 907-2 e cila evidentohet ne emër te Z. (Z.) K., ne pjesën jugore me parcelën nr . 909-0 e cila evidentohet ne emër te Rr. (T.) C. por sipas gjendjes faktike është rruge me emër .....ne pjesën perëndimore me parcelat me nr. 907-5 dhe 908-0 te cilat evidentohet ne emër te E. (R.) K..

Parcela më numër 907-3 kufizohet ne pjesën veriore me parcelën nr. 907-10 e cila evidentohet ne bashkëpronësi ideale me 2/8 Z. (M.) S. me 2/8 V. (M.) S., 1/8 M. (D.) S., 1/8 M. (R.) S., 1/8 B. (S.) A. por sipas gjendjes faktike është rruga me emrin Rr. B., ne pjesën lindore me parcelën 907-1 e cila evidentohet ne emer te Zh. (Zh.) Z. dhe parcelën nr. 907-2 e cila evidentohet ne emer te Z. (Z.) K.. Ne pjesën jugore me parcelën me nr. 909-0 e cila evidentohet emër Rr. (T.) C. por sipas gjendjes faktike është rruga me emër ....., ne pjesën perëndimore me parcelën nr 907-4 e cila evidentohet ne emer te Z. (J.) M.. Ne baze te evidencave kadastrale parcela 906-0 evidentohet ne emër te Z. (Z.) K. , parcela me nr 907-3 evidentohet ne emër te B. (S.) B.. Te cilës ekspertize te kryer ne mënyre profesionale nga ekspereti i gjedozies Xh. T. gjykata ja ka falure besimin

**I autorizuari i paditurit të parë Av.I. I. në pyetjen e berë ekspertit** në legjendën e ekspertizës dhe shpjegimet mirëpo unë në këtë ekspertizë i shoh disa sqarime mirëpo ngjyrat nuk i ka shpjeguar eksperti na sqaron kufizohet me fijen e zezë në skicë e qka në vijën e kuqe **Eksperti gjeodezisë Xh. T. ka deklaruar** me vijë të kuqe është gjendja faktike ndërsa me vijë të zezë është gjendja kadastrale.

**I autorizuari i paditurit të parë Av.I. I. në pyetjen e bere ekspertit** ku është ndryshimi dhe prej nga rrjedh aj ndryshim kur në skicën që e disponojmë me rastin e blerjes gjatësia e vijës përkufizuese në mes ngastrave 907-3 dhe 906-0 ka qenë 28.20 metra ndërsa tani në ekspertizë na paraqitet 26.26 metra **Eksperti i gjeodezisë ka deklaruar** gjatë ario ingjizimit është bërë një gabim teknik, dhe atë shënime ne i kemi marr në kadastër, dhe pjesa prej 80 cm nuk ekziston.

**I autorizuari i paditurit të parë Av.I. I. në pyetjen e bërë ekspertit gjedozies** a depërton ngastra 907-3 në ngastrën 906-0 në tersi nëpër këtë sipërfaqe apo edhe ngastra pasuese që është ma nalt se 907-shi **Eksperti i gjeodezisë ka deklaruar** vetëm të ngastra 907-3.

**I autorizuari i paditurit të parë Av.I. I. në pyetjen e bere ekspertit** ne bazëtë konstatimit të gjendjes në teren a janë qit pikat për drejtimin e pikës kufitare apo jo **Eksperti i gjeodezisë ka deklaruar** jo nuk janë ekzekutuar pikat e kufirit kadastral në teren.

Neni 80 Shënimi dhe instalimet e kufirit 1. Pronarët e paluajtshmërive fqinjë janë të detyruar që të bashkëveprojnë gjatë caktimit e shenjave të përhershëm të kufirit, apo rivendosjen e tyre kur ato janë larguar ose janë bërë të panjohura. Ligji Nr. 03/L-154 për pronësinë dhe te drejtat sendore

### **Administrimi i provave gjatë seancës të shqyrtimit kryesor**

Gjykata gjate seances te shqyrtimit kryesore ke bere administrimin e provave

Lexohet padia e paditësit në gjykatë me dt. 06.06.2019.

Shikohen fotografit dhe skicat që gjen në shkresat e lëndës nga numri 3 deri 5

Shikohet kopja e planit .

Lexohet certifikata e pronësisë me numër 15753 e lëshuar nga Zyra Kadastrale në Deçan me dt. 17.05.2019, me pronar Z. (Z.) K. i njesive kadastrale me numere P 70505021 00906 0, P 70505021 00907 2,

Shikohen fotografit që gjen në shkresat e lëndës nga numri 11-13

Lexohet procesverbali i dal në vendin engjarjes me gjykatën palët paditëse dhe ekspertin datën 11.02.2021.

Lexohet ekspertiza e ekspertit të gjeodezisë Gj. T. e dorëzuar në gjykatë me dt. 12.04.2021 se bashku me fletëpagesën dhe numër të xhirollogarisë se tij për kryerje të ekspertizës me shkrim në shumë prej 250 euro.

Lexohet fatura me numër 0000877 e dorëzuar nga paditësi Z. K. me dt. 16.02.2021 për pagesën e koordinatave.

Te cilave provave qe gjenden ne shkresat elendes gjykata ja ka falure besimin

### **Dispozitat ligjore**

Pasi që gjykata ka bërë vlersimin e secilës provë veç e veç, dhe të gjithave atyre së bashku e në lidhmëri njera me tjetrën dhe nga kjo gjendje e vërtetuar faktike si me larte, erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar në kuptim të Nenit 80 paragraf 1. Të Ligjit Nr. 03/L-154 për pronësinë dhe te drejtat sendore duke vendosur si ne dispozitivë te këtij aktgjykimit.

Vendimin që te paditurit solid arishtë paditësit të ia shpërblej shpenzimet e procedurës, gjykata e mbështeti dispozitat e nenit 452 par. 2 dhe 463 par 1 të LPK-së sepse paditësi si gjyq fituese, i takon e drejta në shpërblimin e shpenzimeve të procedurës më kusht që paditësi ti ketë specifikuar provuar ato për taksë gjyqësore 20.00 euro, për ekspertizën ekspertit gjeodezisë 250.00 euro të gjitha këto ne shumen e përgjithshëm prej 270.00 euro. Mbi ketë shumë refuzohen si të pa bazuar.

Nga sa u tha me larte u vendos si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi.

**NGA GJYKATA THEMELORE PEJË- DEGA DEÇAN, i përpiluar më datën 08.06.2021.**

**Gj Y Q T A R I**  
Bekim Avdimetaj

### **KËSHILLA JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi lejohet e drejta në ankesë, në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes se të njëjtit, Gjykatës se Apelit në Prishtinë e përmes kësaj gjykate.

Numri i lëndës: 2019:149332  
Datë: 08.06.2021  
Numri i dokumentit: 01860595